



# ÇKA TUTJE ME FSK: USHTRI APO JO?

**DOKUMENT I POLITIKAVE**

2013



# Çka tutje me FSK: ushtri apo jo?

Kjo analizë është përgatitur për Forum 2015

Nga: Armend Muja

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Qershor 2013

Ky dokument i politikave është hartuar për Forumin 2015 nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë

Ky vlerësim është inicuar nga Florian QEHAJA, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë

© FORUM 2015 dhe QKSS, Qershor 2013.

---

**Autoret:** **Armend MUJA**

Kontribuesit: Mentor VRAJOLLI

Fjolla RAIFI

Abit HOXHA

Mbështetje nga: Sofije KRYEZIU

Skender PERTESHI

---

Realizimi i këtij projekti është mbështetur financiarisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Imzot Nikë Prela nr. 13

10 000 Prishtinë

Kosovë

Për me shumë:

[info@kfos.org](mailto:info@kfos.org)

[www.kfos.org](http://www.kfos.org)

---

## PËRMBAJTJA

---

|           |                                                                               |           |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>1.</b> | <b>HYRJE.....</b>                                                             | <b>5</b>  |
| <b>2.</b> | <b>METODOLOGJIA.....</b>                                                      | <b>6</b>  |
| <b>3.</b> | <b>SEKTORI I SIGURISË SË KOSOVËS NË MJEDISIN STRATEGJIK BASHKËKOHOR .....</b> | <b>8</b>  |
|           | 3.1 Mjedisi Ushatarak .....                                                   | 9         |
|           | 3.2 Mjedisi Politik .....                                                     | 9         |
|           | 3.3 Mjedisi socio-ekonomik .....                                              | 10        |
|           | 3.4 Sfida të tjera të sigurisë .....                                          | 10        |
| <b>4.</b> | <b>INTERESAT E KOSOVËS DHE QËLLIMET STRATGJIKE .....</b>                      | <b>12</b> |
|           | 4.1 Bashkëpunimi multilateral dhe integrimi.....                              | 13        |
|           | 4.2 Pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare.....                              | /14       |
|           | 4.3 Aftësitë e mbrojtjes.....                                                 | 14        |
| <b>5.</b> | <b>OPSIONET E POLITIKAVE TË MBROJTJES DHE SKENARET PER FSK.....</b>           | <b>16</b> |
|           | 5.1 Përmbledhje e skenareve.....                                              | 17        |
|           | 5.2 Analiza e Skenareve: Implikimet politike .....                            | 18        |
|           | 5.3 Analiza e Skenareve: Implikimet ekonomike .....                           | 21        |
| <b>6.</b> | <b>REKOMANDIMET DHE KONKLuzionET.....</b>                                     | <b>23</b> |

## 1. HYRJE

---

Rishikimi i Sektorit të Sigurisë është një proces i domosdoshëm në funksion të ndryshimeve në ambientin e jashtëm dhe zhvillimeve të brendshme në Kosovë. Zhvillimi i sektorit të sigurisë në Kosovë filloi që nga periudha e pas luftës dhe kulminoi në periudhën pas shpalljes së pavarësisë. Evoluimi i situatës politike që në qëllimet strategjike nacionale, resurset e kufizuara dhe evoluimi i natyrës së kërcënimeve e bejnë të nevojshem një shqyrtim gjithëpërfshirës të sektorit të sigurisë. Ky ushtrim duhet të nxjerrë në pah drejtimit kryesore të prioriteteve të sigurisë si dhe të listoj disa implikime për institucionet e themeluara dhe burimeve të dedikuara për to.

Dekada e kaluar ka përjetuar zhvillime të reja në sferën politike, ekonomike dhe teknologjike. Kjo ka ndryshuar perceptimin e kërcënimeve të aktorëve të mëdhenj ndërkombëtar. Nga ana tjetër, rajoni i Ballkanit Perëndimor është transformuar gradualisht nga një burim i kërcënimit dhe tensionit drejt pjesëmarrjes aktive në formësimin e sigurisë evropiane. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian (BE), ndërsa kohët e fundit një numër i tyre u bashkua me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Megjithatë, sfidat për stabilitetin ende vazhdojnë në rajon. Ajo që duhet të theksohet është se pothuajse të gjitha vendet janë në rrugën e reformave dhe kanë marrë pjesë në mënyrë aktive duke kontribuar në stabilitet dhe paqe.

Burimet e kërcënimeve të jashtme janë bërë gjithnjë e më të paparashikueshme. Burimet më tradicionale dhe konvencionale të kërcënimeve ushtarake janë zëvendësuar nga kërcënimet e reja asimetrike që vijnë nga akterë jo-shtetërorë. Përederisa rajoni duket të jetë stabilizuar nga kërcënimet e konflikteve, në anën tjetër konfliktet potenciale në rajonet fqinje mund të prodhojnë grupe të ndryshme të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare si emigracioni, terrorizmi ndërkombëtar, kërcënimet e armëve biologjike dhe kimike dhe narkotikëve. Ndryshimet në mjedisin rrethues dhe global paraqesin nevojën për një rishikim të plotë të strukturës së sigurisë në Kosovë në mënyrë që qëllimet strategjike të saj të përshtaten me politikën e jashtme të integriteteve euro-atlantike. Strukturat e sigurisë duhet të balancojnë përgjegjësitë e tyre lokale me nevojën për kontribut gradual për paqen rajonale dhe globale. Procesi i rishikimit të sektorit të sigurisë duhet të synojë të ofroj një strukturë të sigurisë që është trajnuar mirë, që është ndërveprues dhe i gatshëm për t'iu përgjigjur kërcënimeve të menjëhershme.

Qëllimi i këtij dokumenti të politikës është që të përshkruaj disa karakteristika kyçe që duhet të adresohen në shqyrtimin e sektorit të sigurisë, si dhe të nxjerrë në pah tre skenare për modelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në të ardhmen. Ky rishikim duhet të metoj t'i përgjigjet prioriteteve lokale dhe ndërkombëtare por edhe për të përcaktuar kompetencat, përgjegjësitë dhe burimet e nevojshme për të përmbushur qëllimet strategjike nacionale. Procesi është diktuar pjesërisht nga kufizimet politike që rezultojnë nga përfshirja e NATO-s në Kosovë dhe kompleksitetin që del nga çështjet e pazgjidhura politike me Serbinë. Megjithatë, kufizimet e lartpërmendura nuk e parandalojnë Kosovën dhe strukturat e saj

për të adoptuar nje strukture të sigurisë për të përmbushur kërkesat bashkëkohore dhe kërkesat që burojnë nga ambicjet e saj për anëtarësim në NATO dhe BE.

## 2. METODOLOGJIA

---

Qëllimi i këtij dokumenti të politikave është që të përshkruajë kërcënimet, interesat dhe shtigjet e mundshme të veprimit në strukturimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Procesi i rishikimit të sektorit të sigurisë është një proces kompleks që përfshin shumë institucione dhe fusha studimore. Megjithatë, ky hulumtim fokusohet vetëm në komponentin e mbrojtjes dhe ushtrisë. Studimi është një përpjekje për të nënvizuar disa qasje në ushtrimin e rishikimit të sektorit të sigurisë. Ky përfaqëson një hap të parë nga një perspektivë jo-qeveritare dhe ka për qëllim gjenerimin e një debati më të plotë mbi këtë çështje. Përveç përkufizimit të kërcënimeve bashkëkohore, sfidat dhe rreziqet, punimi gjithashtu thekson qasjet programatike dhe arritjet që Kosova ka për të përmbushur në arritjen e objektivave strategjike të saj të sigurisë. Punimi propozon dhe përpunon tre skenarë të mundshëm për të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kur përballemi me opsione komplekse në procesin e politikë-bërjes, shumica e qasjeve tentojnë të ofrojnë analiza krahasuese - ato krahasojnë dhe ballafaqojnë një menu mundësish në kërkim të opcionit më të mirë. Një analizë e caktuar e këtij lloji mund të vlerësojë performancën e një politike ekzistuese, të shqyrtojë një opsion të vetëm të ri për të zëvendësuar atë apo edhe krahasim të rezultateve që prodhon ky opsion. Një qasje e tillë mund të zbatohet edhe duke krahasuar dhe ballafaquar një grup të madh të opsioneve alternative ndoshta tre, pesë, apo edhe më shumë. Analiza gjithashtu mund të shqyrtojë se si këto opsione mund të arrijnë një qëllim të vetëm, apo si ato mund të arrijnë disa qëllime në të njëjtën kohë. Ajo mund të fokusohet në qëllime të shumta, të zhvillojë një politikë të veçantë për secilin prej tyre apo të rekomandojë një politikë të veçantë që mund të jetë një kombinim të tyre për të ofruar një qasje koherente. Politikë-bërësit në këso rastesh mund të vlerësojë rrugetimin më të mirë se si duhet koordinuar dhe sinkronizuar ekzekutimin e këtyre politikave.

Kjo analizë e politikave bazohet në një qasje të kombinuar të metodologjisë në përpjekje për t'i mundësuar lexuesit shpjegimin e anës strategjiko-politike [anës sistematike], por gjithashtu edhe mundësinë e matjes së implikimeve ekonomike të secilit opsion. Metodatat e vlerësimit strategjik (*strategic evaluation*) zakonisht përdoren për analizimin e çështjeve të mëdha strategjike. Këto metoda përdoren nga shkencëtarët politik dhe janë të natyrës cilësore sesa sasiore. Kjo metodë është më tepër e prirur për të vënë në pah gjykimet e gjera në lidhje me sektorin se sa për të ofruar vlerësime të detajuara. Megjithatë, për të plotësuar këtë kufizim dhe përforcuar informacionin prapa secilit argument, studimi inkorporon metodën e vlerësimit të sistemeve (*system analysis*). Vlera e shtuar e kësaj metode është mundësia për të ofruar paraqitje grafike dhe ofruar përllogaritje të përafërta për të mundësuar vlerësimin e kosto-efektivitetit të opsioneve të ndryshme. Kjo ka rëndësi të veçantë sidomos kur kemi të bëjmë me shërbime që konsumojnë resurse të mëdha financiare sic është sistemi ushtarak dhe i armatimeve.

Në përgjithësi, punimi fillimisht ofron një vlerësim strategjik në mënyrë që të gjeneroj dhe krahasoj alternativat e mundshme politike. Ky nivel i analizës ka ndihmuar ekipin e kërkimit

për të listuar perkufizimin e kërcënimeve dhe për të nxjerrë në pah interesat strategjike dhe qëllimet e Kosovës. Vlerësimet e opsioneve të politikave dhe vlerësimet të planeve mbështeten në analizën e metodave të sistemeve. Disa nga informacionet e nevojshme për të ushqyer vlerësimin strategjik janë arritur nëpërmjet hulumtimeve dhe intervistave me palët e interesuara. Metodatat e Analizës së Sistemit dhe kostoja e skenarëve janë mbështetur në supozime edhe informacione statistikore nga organizatat ndërkombëtare dhe përpunim të statistikave qeveritare.

Studimi është zhvilluar dhe implementuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë mbi bazën e qasjeve metodologjike gjenerike në analizën e politikave të rishikimit të mbrojtjes. Ne duhet të pranojmë se ka pasur disa kufizime në procesin kërkimor. Së pari, pavarësisht nga mbështetja bujare nga Fondacioni KFOS, një studim i këtij lloji ka nevojë për më shumë kohë dhe resurse. Së dyti, vlerësimet statistikore shpesh mbështeten në të dhënat dytësore, disa të dhënave mungonin apo shtete të ndryshme përdorin kategori të ndryshme të të dhënave. Së treti, ekipi hulumtues do të preferonte më shumë të dhëna të përditësuara dhe më shumë kohë për të përpunuar ato. Së fundi, ekipi hulumtues do të kishte preferuar më shumë kohë dhe burime për të konsultuar dhe intervistuar të gjithë akterët.

### **3. SEKTORI I SIGURISE NE AMBIENTIN STRATEGJII BASHKEKOHOR**

---

Që nga periudha e pas pavarësisë, mjedisi bashkëkohor strategjik për sektorin e sigurisë në Kosovë ka rezultuar të jetë mjaft kompleks si rrjedhojë e rritjes së paqëndrueshme në fushën socio-ekonomike, sfidave të mjedisit jetësor, zhvillimeve teknologjike dhe një mjedisi kompleks politik. Në ditët e sotme Kosova gëzon një siguri relative. Pavarësisht nga përvoja e hidhur gjatë konfliktit dhe mosmarrëveshjeve politike me Serbinë mbi statusin e saj, vetëm një pjesë e papërfillshme e qytetarëve vlerësuan ndonjë kërcënim të drejtëpërdrejtë ushtarak nga jashtë (Barometri Kosovar i Sigurisë, 2013). Sikurëse edhe vendet e tjera të rajonit Kosova mund të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve asimetrike, jo-konvencionale të sigurisë dhe kërcënimeve. Si një shtet i ri, Kosova është e vogël në madhësi me burime të kufizuara dhe është mbështetur kryesisht në praninë e trupave të NATO-s për të kompensuar sfidat afat-shkurtëra ndaj sigurisë së saj. Marrëveshja e fundit me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve ka trasuar mundësinë për një bashkëpunim më të madh rajonal dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e sigurisë kolektive.

Kosova në fakt ka dalë nga një konflikt me Serbinë jo shumë kohë më parë. Ajo ka shpallur pavarësinë e saj në vitin 2008 dhe përkundër disa fërkimeve të vogla ndër-etnike, gëzon një lloj stabiliteti relativ. Marrëdhëniet me Serbinë kanë mbetur të tensionuara por të qëndrueshme. Mosmarrëveshjet mbi statusin dhe kundërshtimet e Serbisë, shpesh e kanë pamundësuar shtrirjen e Kosovës në iniciativa rajonale. Megjithatë, si Kosova ashtu edhe Serbia kanë institucionalizuar procesin e integritit në BE dhe kjo duhet të kontribuoj në lehtësimin e mosmarrëveshjeve të mbetura në mes të dy vendeve. Kosova ende përballet me sfidat e sundimit të ligjit dhe me institucione fragjile. Institucionet e Kosoves kanë hasur në probleme gjatë përpjekjes së shtrirjes së autoritetit të tyre në pjesën veriore si rezultat i refuzimit të serbëve të Kosovës për të njohur ligjshmërinë e institucioneve të daluara nga Plani i Ahtisarit.

Ndër format më të dukshme të kërcënimit të jashtëm ndaj sigurisë nacionale të Kosovës janë krimi i organizuar ndërkombëtar, migrimi i paligjshëm, terrorizmi ndërkombëtar dhe përhapja e mundshme e armëve të shkatërrimit në masë. Nga ana tjetër, ajo është sfiduar edhe nga burime të tjera të tërthorta por të paparashikueshme të kërcënimit nga zhvillimet politike në Ballkanin Perëndimor, ndikimi i krizës ekonomike dhe nivelet e ulëta socio-ekonomike, sfidat mjedisore dhe kërcënimet që rrjedhin nga globalizimi dhe zhvillimet teknologjike. Shumica e kërcënimeve, rreziqeve dhe sfidave me të cilat ajo përballet janë rajonale dhe transnacionale në natyrë, dhe shi për këtë është thelbësore që institucionet të bëjnë pjesë e iniciativave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të marrin pjesë në mekanizmat e mbrojtjes kolektive në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

#### **3.1 Mjedisi ushtarak**

Rëndësia e mjedisit ushtarak ka ndryshuar që nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe përfundimit të konfliktit në ish-Jugosllavi. Prania e forcave të NATO-s në Kosovë ka kompensuar shqetësimet e ndonjë sulmi të mundshëm të jashtëm ushtarak në periudhën e pasluftës. Kosova nuk është nën ndonjë kërcënim iminent ushtarak. Anipse mosmarrëveshjet politike



dhe rivalitetet ende janë pjesë e përditshmërisë së Ballkanit Perëndimor , të gjitha ushtritë nacionale janë kyqyr në një apo proces tjetër të reformimit dhe zvogëlimit të forcave ushtarake. Kroacia dhe Shqipëria janë bërë anëtarë të NATO-s, ndërsa Maqedonia mbeti jashtë ofertës së anëtarësimit të kaluar për shkak të kundërshtimeve nga Greqia. Serbia ka miratuar një politikë neutrale ushtarake dhe refuzon të kërkoj anëtarësim në NATO. Përderisa kemi prezencë të trupave ndërkombëtare në rajon dhe shtetet të jenë vendosëshmërisht të angazhuara në rrugën drejt integritit në BE , pak do prisnin që mjetet ushtarake të përdoren për zgjedhjen e mos-marrëveshjeve politike në Ballkanin Perëndimor. Sulmet e drejtpërdrejta ushtarake ndaj Kosovës mbeten të largëta edhe pse jo krejtësisht të pamundura.

Në të ardhmen, burimet themelore të kërcënimeve të sigurisë do të vijnë nga zonat e destabilizuara politikisht [p.sh. Lindja e Mesme], organizatat terroriste, grupe ndërkombëtare të krimit të organizuar dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë. Forcat e armatosura dhe të mbrojtjes do të duhet të riorientojnë strategjitë dhe mjetet e tyre për neutralizimin e këtyre burimeve të kërcënimeve. Kosova së bashku me vendet në rajon janë të vogla dhe me mungesë të burimeve për të trajtuar kërcënimet globale dhe kjo kërkon pjesëmarrjen e tyre në operacione të përbashkëta dhe ndërkombëtare. Paparashikueshmëria dhe fushëveprimi i kërcënimeve kërkojnë që shtetet të ndërtojnë struktura ushtarake që janë në gjendje për tu përshtatur dhe reaguuar shpejt ndaj dinamikave globale.

Forcat e sigurisë do të duhet të jenë të gatshme për reagime të shpejta ndaj krizës potenciale dhe të jenë të përgatitura për dislokim të shpejtë. Forcat e sigurisë gjithashtu duhet të jetë në gjendje për të reaguuar ndaj natyrave të ndryshme të kërcënimeve duke përfshirë ato që lidhen me mbrojtjen e integritetit territorial, për t'iu përgjigjur ndaj krizave ndërkombëtare dhe operacioneve civile në rastet e katastrofave natyrore dhe emergjencave civile. Ndryshimet në mjedisin strategjik diktojnë llojin e ushtrimeve, ortakëritë, zhvillimin e koncepteve dhe doktrinave dhe blerjen e pajisjeve. Luftat e pazakonta asimetrike dhe luftat sistemi-kundër-sistemit janë duke zëvendësuar konceptin e luftës konvencionale 'një ushtri kundër ushtrisë tjetër.

### **3.2 Mjedisi politik**

Pavarësisht konsolidimit të gjendjes së sigurisë, rajoni dhe Kosova si pjesë e saj, do të vazhdojnë të kenë nevojë për nisma për të parandaluar tensionet politike në të ardhmen. Serbia, së bashku me një numër të madh të akterëve ndërkombëtarë po vazhdon të sfidojë ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Autoritetet e Beogradit janë përmbajtur nga ndërhyrja direkte por kanë vazhduar të pengojnë forcimin dhe zgjerimin e autoritetit të institucioneve të Kosovës në përgjithësi dhe ato të sigurisë në veçanti. Deri më sot, Serbia vazhdon të financojë institucionet paralele administrative dhe të sigurisë në zonat me mbizotërim serb në Kosovë.

Komuniteti ndërkombëtar ka ndërhyrë shpesh për të parandaluar transformimin e tensioneve politike në konflikt të hapur. Banorët serbë në veri të Kosovës u përgjigjën me demonstrata të zemëruara dhe bllokada rrugore përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për të parandaluar hyrjen e mallërave të pa-tatuara. Megjithatë, mosmarrëveshjet politike janë qetësuar kohët e fundit me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare. Prishtina dhe Beogradi nënshkruan një marrëveshje në prill 2013 për normalizimin e marrëdhënieve nën

patronazhin e Bashkimit Evropian - ajo përcakton çmontimin e strukturave të Serbisë në veri në këmbim të një shkalle më të madhe të autonomisë për komunat veriore të banuara me serbë. Marrëdhëniet e tensionuara me Serbinë mbeten një sfidë por jo një kërcënim i drejtpërdrejtë.

Integrimi i Ballkanit Perëndimor dhe Kosovës në institucionet evropiane politike, ekonomike dhe të sigurisë do të zvogëlojë potencialin për paqëndrueshmërinë politike dhe inkurajojë bashkëpunimin rajonal. Sidomos anëtarësimi në Bashkimin Evropian do të shërbejë si një katalizator për të neutralizuar burimet e tensioneve politike në Serbi dhe Kosovë. Ajo gjithashtu duhet të çojë në një relaksim të obstrukcioneve të Serbisë dhe inkorporimit të Kosovës në mekanizmat rajonale politike, ekonomike dhe të sigurisë. Ndrejta e marrëdhënieve me Serbinë është e rëndësishme për të hequr kundërshtimin e anëtarëve të BE-së që ende se kanë njohur Kosovën drejt nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Komisionin Evropian. Një organizatë tjetër me rëndësi të veçantë sa i përket shqetësimit për stabilitetin politik është NATO. Ajo ka luajtur një rol aktiv në Kosovë përmes KFOR-it që nga periudha e pasluftës. Kosova ka përfituar nga kontributi i sigurisë të shteteve të anëtarëve të NATO-s, por nuk ka hyrë në një modalitet të bashkëpunimit formal me Aleancën. E lartëcekura ka pasur vështirësi për të ruajtur konsensusin e të gjitha shteteve anëtare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

### **3.3 Mjedisi socio-ekonomik**

Mjedisi socio-ekonomik ndikon drejtpërdrejt dhe formon proceset politike dhe të sigurisë, prandaj është një element thelbësor i sigurisë. Ekonomitë janë duke u bërë gjithnjë e më të ndërlidhura dhe të ndërvarura dhe më të ndjeshme ndaj tendencave globale ekonomike. Kosova ballafaqohet me papunësi serioze dhe probleme të varfërisë. Normat e varfërisë janë më të lartat në Evropë. Vendi është pa dalje në det dhe ekonomia e saj ka vuajtur nga një periudhë e gjatë e neglizhencës dhe mungesës së investimeve. Ekonomia ka qenë në rritje në mënyrë të vazhdueshme në vitet e fundit, por që nuk ka bërë shumë për të kompensuar presionin shoqëror. Struktura demografike e Kosovës është e dominuar nga të rinjtë - shumica e të cilëve janë të papunë. Norma e rritjes dhe zhvillimit të sektorit privat është shumë e ngadalshme për të akomoduar kërkesat për punë. Ekonomia dhe mirëqenia ende mbështeten në remitancat dhe ndihmat ndërkombëtare.

Kriza e fundit ekonomike dhe e borxhit në Evropë ka ndikuar negativisht në vendet e Ballkanit Perëndimor - Norma e rritjes gati ka ngecur (FMN, 2011). Pasojat negative të krizës kanë prekur të ardhurat dhe mirëqenien e njerëzve. Shpenzimet e qeverive në rajon për shtetin e mirëqenies kanë rënë që nga viti 2008 (Bartlett, 2009). Nivelet e kënaqshmërisë me jetesën kanë rënë ndjeshëm sikurëse edhe besimi i njerëzve në institucione (Balkan Monitor, 2010). Këto pasoja për rajonin dëshmojnë mbi mundësinë e rreziqeve të jashtme që mund të sfidojnë stabilitetin. Sondazhi Barometri i Sigurisë për Kosovë (2013) ka gjetur se Kosovarët e perceptojnë situatën ekonomike të Kosovës si sfidën më madhore dhe sigurinë e saj.

Anëtarësimi i Kosovës në Marrëveshjen e Evropës Qendrore e Tregtisë së Lirë (CEFTA), dhe perspektiva e anëtarësimit në BE me siguri do të ketë efekte pozitive në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Bashkëpunimi rajonal politik dhe ekonomik në një përpjekje për të minimizuar rreziqet e perceptuara politike rajonale duhet gjithashtu të jenë të dobishme në inkurajimin e investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe shkëmbimin e kapitalit. Megjithatë,

hapja e ekonomisë së Kosovës ndaj tregtisë dhe konkurrencës globale do ta bëjë atë më të ndjeshme edhe ndaj zhvillimeve negative në ekonominë globale. Kosova do të jetë subjekt i tundjeve asimetrike për aq sa avancon integrimi i saj në ciklin botëror të biznesit. Forcat e konkurrencës globale domosdoshmërisht do të shkaktojnë tensione në shoqëri derisa ajo të përshtatet me më shumë konkurrencë. Kosova ka nevojë për të formuluar një politikë sociale për të ofruar një nivel sigurie sociale për të absorbuar ri-përshtatjet ekonomike në të ardhëmen.

### ***3.4 Sfidat tjera***

Kosova në vitet e fundit u përball me disa raste të fatkeqësive natyrore si përmytjet, ortehtë, rrëshqitjet e tokës dhe tërmetet. Përveç kësaj, mbeturinat industriale dhe kimike nga Kompleksi i Trepçës dhe Temocentralet në Obiliq vazhdojnë të paraqesin rrezik për popullatën e përgjithshme. Të dy burimet e rreziqeve natyrore dhe rreziqet e tjera të shkaktuara nga njeriu ende janë prezente në shoqërinë e Kosovës. Përveç kësaj, Kosova duhet llogaritur edhe avancimin teknologjik gjatë dekadave të fundit dhe sfidat që krijon kjo për sigurinë e saj. Inkursionet në sistemet e informacionit, bllokimet e tëra të sistemeve, aksesit i paautorizuar dhe përhapja e mundshme e informacioneve të pasakta janë forma të reja të kërcënimeve që janë bërë të mundura nga përdorimi i teknologjisë së informacionit

## 4. INTERESAT DHE QELLIMET STRATEGJIKE TE KOSOVES

---

Politika e sigurisë nacionale është një ekuilibër i aktiviteteve dhe programeve që përbëjnë politikën e jashtme, të mbrojtjes, si dhe politikën ekonomike, sociale dhe kulturore. Qëllimi më i rëndësishëm i politikës së sigurisë të Kosovës që buron nga interesat dhe vlerat strategjike është për të siguruar qytetarët e saj, për të sforcuar sigurinë dhe stabilitetin regional dhe global. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj në vitin 2008 andaj institucionet e saj janë ende në fazën e zhvillimit. Megjithatë, angazhimi për të ndjekur integrimin në Bashkimin Evropian, NATO dhe OKB mbetet si njeri ndër prioritetet më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në fakt, Qeveria ka deklaruar se objektivi i saj mbetet konsolidimi i marrëdhënieve ndërkombëtare; ndjekja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi aktiv me organizatat politike dhe ekonomike të Evropës Jug-Lindore.

Kosova ende mbetet një vend i vogël në aspektin e sigurisë globale si rezultat i burimeve të kufizuara. Në fakt, ende qëndron në fazën e konsolidimit të demokracisë dhe institucioneve të saj. Pas një dekade nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara, Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia në vitin 2008. Edhe pse shumica e vendeve të BE-së dhe NATO-s tashmë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ende ka anëtarë që kanë dështuar të miratojnë aktin e njohjes. Me saktësisht, afro gjysma e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara deri më tani kanë njohur Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur. Në fakt, dështimi për të fituar njohje nga një numër kyç shtetesh ka rezultuar në ngadalësimin e integritit të Kosovës në BE dhe NATO. Kosova është vendi i vetëm në rajon që nuk ka një Marrëveshje Stabilizim-Asocimi me BE-në. Ndërsa prezenca e NATO-s ka sjelle përfitime të mëdha për zhvillimet në Kosovë, rruga drejt pjesëmarrjes në strukturat e NATO-s ende mbetet e paqartë dhe e paralizuar. Serbia vazhdon të pretendojë se Kosova është ende pjesë e territorit të saj. Refuzimi i Serbisë për të pranuar Kosovën si një shtet sovran ka paraqitur një numër të madh të sfidave të brendshme dhe vështirësi në pjesëmarrjen e nismave rajonale në dimensionin politik dhe ekonomik.

Megjithatë, Bashkimi Evropian ka ndërmjetësuar dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës i cili ka rezultuar në përmirësimin e marrëdhënieve mes dy shteteve dhe relaksim të qasjes kundërshtuese të Serbisë ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në institucionet rajonale. Këto arritje u kurorëzuan me Marrëveshjen e Brukselit (2013) mbi normalizimin e marrëdhënieve. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës kanë përkrahur marrëveshjen si një hap i mirë drejt konsolidimit të shtetësisë së Kosovës dhe një hap drejt hapjes së perspektivës së integritit Evropian. Teksti i marrëveshjes, ndër të deklaron se as Kosova dhe as Serbia nuk duhet të pengojë rrugën e njëra tjetrës drejt integritimit Evropian. Kjo mund të krijojë një mjedis strukturor të besimit dhe bashkëpunimit, si një mënyrë për të siguruar sigurinë afatgjatë të Kosovës.

Në fakt, për të ndjekur politikën e saj të sigurisë nacionale dhe qëllimet strategjike, Kosova duhet arritur një sërë objektivash të rëndësishme (a) të ndërtojë marrëdhënie të mira fqinjësore, (b) në mënyrë aktive të marr pjesë në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal, (c) të nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me BE, (d) të marr pjesë në Partneritetin për Paqe të NATO-s si një hap i parë drejt anëtarësimit të plotë, (e) të synojë anëtarësim dhe bashkëpunimin në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si dhe (f) të synojë anëtarësim në Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Në parim, Kosova duhet të ndjekë një politikë të mbrojtjes të përqendruar në prioritetet e integritit dhe bashkëpunimit shumëkombësh, pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare

për paq-ruajtje, të vazhdojë konsolidimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në një strukturë të gatshme që kontribuon për qëllime të sigurisë, si dhe të rrisë burimet e veta të mbrojtjes.

#### ***4.1 Integrimi dhe Bashkëpunimi Multilateral***

Politika e sigurisë nacionale duhet të ndërtohet dhe udhëhiqet në bazë të politikave të Integritit Evropian dhe pjesëmarrjes në Sigurinë Evropiane dhe Politikën të Mbrojtjes (ESDP). Me saktësisht, Samiti i Selanikut (2003) ka paraqitur për Kosovën dhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimorë perspektivën e integritit Evropian. Megjithatë, normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës me BE-në ka hasur në vështirësi si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të brendshme brenda Bashkimit – ku pesë shtete anëtare të BE-së ende vazhdojnë të mos e njohin shtetësinë e Kosovës. Nga ana tjetër, në Kosovë vazhdon të funksionoj misioni i BE-së për sundimin e ligjit duke marrë ndihmë të rëndësishme si pjesë e Instrumentit të Para-Asocimit (IPA). Edhe pse bashkëpunimi me instrumentet dhe programet e BE-së ka përparuar gjatë viteve të kaluara, procesi ende mbetet i komplikuar për shkak të politikës së BE-se mbi neutralitetin e statusit.

Si qeveria, ashtu edhe elita politike janë përkrahës të vendosur ndaj integritit në BE si një qëllim strategjik nacional. Gjithashtu, shumica dërrmuese e popullsisë së Kosovës është në mënyrë të vendosur në mbështetje të procesit të integritit (Barometri i Sigurisë së Kosovës, 2013). Në fakt, Kosovës u është ofruar procesi liberalizimit të vizave nga Komisioni Evropian në vitin 2012 dhe kjo paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për dialog mbi shqetësimet e sigurisë. Përveç kësaj, ky proces shërben si një katalizator i rëndësishëm për Evropianizimin e praktikave të sigurisë. Megjithatë, Qeveria ende pret dritën e gjelbër nga Komisioni Evropian mbi Mekanizmin e Stabilizimit Asocimit - proces që duhet të zyrtarizojë dhe të modernizojë dialogun me BE-në, si dhe të sigurojë mënyra të ndryshme për përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit. E gjithë kjo rezulton nga fakti se perspektiva Evropiane e Kosovës ofron një zhvillim të rëndësishëm për bashkëpunimin rajonal dhe stabilizim në Ballkanin Perëndimor.

Në periudhën e pasluftës, NATO-ja ishte faktor i rëndësishëm dhe shumë aktiv në themelimin e aparatit të sigurisë në Kosovë. Forcat e KFOR-i ishin përgjegjës për sigurinë e Kosovës. Pavarësisht nivelit të lartë të përfshirjes së drejtpërdrejtë të NATO-s në Kosovë për më shumë se një dekadë dhe pavarësisht nga fakti se vendet fqinje tashmë kanë nënshkruar programet e Partneritetit për Paqe (PFP) me NATO-n, Kosova mbetet vendi i vetëm jashtë këtyre bisedimeve. Megjithatë, Kosova ishte ende në procesin e ngritjes së kapaciteteve dhe si i tillë nuk mund të konsiderohej si vend kandidat drejt marrëveshjeve Euro-Atlantike. Prandaj kjo mund të jetë njëra ndër arsyet pse institucionet e Kosovës nuk janë zyrtarisht të gatshme për të filluar procesin e aplikimit në NATO si dhe nënshkrimin të PFP-së. Gjithashtu, fakti se disa nga anëtarët e NATO-s kanë qenë pragmatik ndaj ndihmës dhe trajnimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duhet të theksohet se marrëdhëniet mes Kosovës dhe NATO-s ka mundësi të kundërshtohen edhe nga opozita e brendshme e saj.

Këto vonesa nuk rezultonin vetëm nga kufizimet politike, por edhe nga tranzisioni i brendshëm i sektorit të sigurisë i cili u zhvillua gjatë katër viteve të fundit. Megjithatë, duke konsideruar se sektori i Sigurisë së Kosovës tashmë ka hyrë në fazën e tij përfundimtare të rishikimit strategjik, shprehja e interesit për integrimin Euro-Atlantik ka filluar të ketë prioritet të lartë në agjendën institucionale. Shumica dërrmuese e Kosovarëve e konsiderojnë anëtarësimin në NATO si një gjë të mirë për Kosovën dhe janë të mendimit se ajo së bashku me integrimin në BE zgjidh dilemat e tyre të sigurisë (Barometri i Sigurisë së

Kosovës, 2013).

Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara - dy anëtarët e këshillit të Sigurimit të OKB-së kundërshtojnë pavarësinë dhe anëtarësinë e saj. Anëtarësimi në OKB është një faktor i rëndësishëm për politika të sigurisë së Kosovës. Gjithashtu, anëtarësimi shërben edhe si një mekanizëm i rritjes së bashkëpunimit në sfidat e sigurisë, si dhe mundësimin për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare të parandalimit të konflikteve dhe paqëmbajtjes. Megjithatë, mbi të gjitha, strukturat e sigurisë së Kosovës duhet të synojnë në nënshkrimin e një memorandum bashkëpunimi afatgjatë me Kombet e Bashkuara – Brigada e forcave në gatishmëri. Duke marrë parasysh kompleksitetin e anëtarësimit në organizata multilaterale, Kosova duhet të kërkojë pjesëmarrje aktive në iniciativa rajonale të sigurisë mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Jug-Lindore.

#### ***4.2 Pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare***

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Forca e Sigurisë së Kosovës mbetet në fazën e konsolidimit. Themelimi i kësaj force, procedurat e operacioneve standarde, si dhe mandati i saj ishin nën mbikëqyrjen dhe autoritetin e ushtrisë ndërkombëtare. Ndërsa, Qeveria e Kosovës është në procesin e kërkimit të miratimit përfundimtar të kapaciteteve të operimit (FOC) nga Këshilli i NATO-s. Konfirmimi i FOC-ve është vonuar për shkak të rishikimit të brendshëm të sektorit të sigurisë dhe hezitimeve nga një numër i shteteve anëtare të NATO-s (ELIAMEP, 2013).

Në dritën e sfidave operacionale dhe kompleksitetin politik, Forca e Sigurisë së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për të kontribuar për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës thekson se "FSK-ja .. mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare" (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Gjithashtu, Kuvendi i Kosovës së fundi ka miratuar Ligjin për Mbikëqyrjen e vendosjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit duke synuar të rregulloj pjesëmarrjen e saj në operacionet e mbështetjes së paqes, operacionet humanitare dhe trajnime të ndryshme. Megjithatë, pjesëmarrja e FSK-së në misionet ndërkombëtare ka ngecur për arsye operacionale dhe politike. Suksesi me i madh është treguar në kryerjen e misioneve humanitare si dhe në operacionin e shpëtimit të Shqipërisë në menaxhimin e fatkeqësisë të përmbytjeve në vitin 2011. Në parim, pjesëmarrja e forcës në misione ndërkombëtare duhet të bëhet nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale me vendet përkatëse dhe jo përmes marrëveshjeve shumëpalëshe në këndvështrimin e sfidave ekzistuese politike.

#### ***4.3 Aftësitë Mbrojtëse***

Mandati ushtarak për të kryer detyra në kuadër të integritetit territorial është një detyrë konvencionale dhe e zbatueshme për të gjitha shtetet sovraane. Ky mandat nënkupton detyrat parimore të të gjitha sulmeve ushtarake apo çfarëdo lloj sulmesh të tjera të jashtme jo-konvencionale që kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve të saj. Edhe pse ulja e kërcënimeve ushtarake në Evropë (dhe në Ballkanin Perëndimor) dobësoi argumentet për të investuar në këtë fushë, të gjitha forcat ushtarake Evropiane vazhduan të qëndrojnë dhe ushtrojnë këtë mandat. Në një fare mënyre, mandati po bëhet simbolik dhe shtyllë e rëndësishme e sektorit të mbrojtjes bashkëkohore.

Për momentin në Kosovë, prania ndërkombëtare ushtarake (KFOR) është autoriteti i vetëm që ushtron këtë mandat që nga periudha e kaluar konfliktuale. Struktura e mandatit është e bazuar në Rezolutën 1244 të OKB-së për Kosovën, si dhe Marrëveshjen Ushtarake-Teknike (Marrëveshja e Kumanovës). Megjithatë, dhe në veçanti, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës ka pasur ndryshime të rëndësishme në strukturën dhe punën e KFOR-it në terren. Numri i trupave të KFOR ka pasur rënie drastike me një situatë të përmirësuar të sigurisë; përgjegjësitë për kontrollin e kufirit me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë janë transferuar në Policinë e Kosovës, si dhe shtrirja gjeografike e performancës së KFOR-it është kryesisht e fokusuar në pjesën veriore të Kosovës.

Vlen të ceket se institucionet Kosovare të sigurisë, sidomos FSK, nuk ka ushtruar asnjë kompetencë mbi mbrojtjen e integritetit territorial. Legjislacioni ekzistues nuk paraqet një mandat të qartë për FSK në kryerjen e detyrave ndaj sigurimit të integritetit territorial. Megjithatë, dispozitat kushtetuese lejojnë interpretime të ndryshme si...Neni 125 e bën të qartë se "Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurisë...dhe kontrollit kufitar brenda territorit të saj". Përkundër mungesës së referencës të drejtpërdrejtë të strukturës ose politikave të mbrojtjes, dispozitat kushtetuese njohin autoritetin e Presidentit të Kosovës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në raste të nevojshme. Në përgjithësi, legjislacioni ekzistues nuk rregullon në mënyrë eksplicite mandatin e FSK-së për të siguruar integritetin territorial në Kosovë, por në anën tjetër nuk ekzistojnë dispozita ligjore që ndalojnë atë.

Në parim, mandati thelbësor ekzistues i FSK-së është ushtrimi i ndihmave në raste fatkeqësish dhe detyrat e mbrojtjes civile. Fokusi i institucionit ishte i përqendruar vetëm në rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes civile. Mandati i Mbrojtjes Civile të FSK-së është i rregulluar në mënyrë të qartë me Ligjin për FSK-në. Ky mandat është përcaktuar në mënyrë që të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj rreziqeve natyrore, si pjesë e reagimit ndaj krizave rajonale ose ndërkombëtare për të kryer çmontimin e pajisjeve shpërthyes dhe operationet e mbrojtjes civile. Ndërsa, forca e ardhshme mbrojtëse me aftësi të konsoliduara të mbrojtjes civile mund të shërbejë edhe në përpjekjet rajonale dhe ndërkombëtare për menaxhimin e krizave. Gjithashtu, Kosova duhet të ndërmarrë hapa paralele drejt anëtarësimit në NATO dhe përmbajtjes së konceptit 'mbrojtës së zgjuar', e cila kërkon nga secili anëtar kontributin dhe ofrimin e ekspertizën së tyre. Për momentin, FSK-ja mund të ofrojë njërin nga këto specializime: mbrojtja civile (sidomos detyrat e shpëtimit urban) ose asgjësimin shpërthyes (duke përfshirë dimimin).

## **5. OPCIONET E POLITIKES SE MBROJTJES DHE SKENARET MBI TE ARDHEMEN E FORCES SE SIGURISE SE KOSOVES**

---

Konteksti i zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë ndryshon dukshëm nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Institucionet e sigurisë në Kosovë ishin kryesisht të ndërtuara nga zeroja me mbështetjen e plotë të bashkësisë ndërkombëtare. Nuk kishte asnjë korrelacion institucional ndërmjet strukturave të sigurisë të ish-Jugosllavisë dhe institucioneve të sigurisë në Kosovë në periudhën e pas luftës. Sektori i sigurisë përmban tri faza kryesore të zhvillimit të tij: Faza e parë (1999-2005) shënoi krijimin e institucioneve të para të sigurisë në Kosovë, sidomos Policia e Kosovës dhe strukturat e emergjencës civile; Faza e dytë (2005-2008) theksoi fillimin e dorëzimit të përgjegjësive nga komuniteti ndërkombëtar tek Qeveria e Kosovës (kjo periudhë ka reflektuar edhe në ngritjen e strukturave civile); Faza e tretë (2008-2013) paraqet një arkitekturë të re të sektorit të sigurisë në dritën e shtetësisë së Kosovës. Në fakt, faza e tretë reflekton një sektor të kompletuar të sigurisë, ku krijohen edhe institucionet e reja të sigurisë si: Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Në të gjitha tri fazat, argumenti mbizotërues për zhvillimin e sektorit të sigurisë është i mbështetur në Rezolutën 1244 të OKB-së për Kosovën dhe sugjerimet e ofruara nga aktorët ndërkombëtarë. Gjithashtu, këto argumente reflektuan mbi stabilitetin politik.

Elementi kryesor i të tri fazave të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë është se përzgjedhja e politikave është bazuar në qasjen nga 'lart-poshtë' me shumë pak ndërhyrje nga aktorët vendas ose nga natyra dhe shtrirja e kërcënimeve me të cilat ballafaqohet Kosova. Vendimet në lidhje me strukturën institucionale të sektorit janë zbatuar me peripikmeri në mënyrë që të balancojë kërkesat lokale me shqetësimet dhe politikat rajonale e ndërkombëtare. Megjithatë, afro katërmëdhjetë vjet pas luftës dhe pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, sektori i sigurisë premtion një situatë me potencial dhe qasje të ndryshme. Sidoqoftë, është e domosdoshme që parimi i pronësisë vendore të mbizotërojë të strukturat e politikave të ndryshme. Gjithashtu, shqyrtimi i vazhdueshëm i sektorit të sigurisë në Kosovë ofron një mundësi të mirë për të krijuar një politikë të sigurisë nacionale dhe strukturë që është e dizajnuar mbi parimet e demokracisë. Në fakt, shtrirja e reformave dhe analiza e sektorit të sigurisë është e gjerë. Ky punim analizon dhe shtjellon të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kapitujt e mëparshëm vënë në pah kërcënimet kryesore si dhe interesat dhe vlerat e Kosovës. Nga ana tjetër, ky seksion paraqet një listë të skenarëve të strukturuar bazuar në disa kriteret analitike. Çdo opsion duhet të paraqes një kuptim të qartë të qëllimit dhe një bazë për përcaktimin se instrumentet e saj janë funksionale në përmbushjen e qëllimeve të paracaktuara. Numri i opsioneve të ekzaminuara është si rrjedhojë e situatës momentale në terren. Në disa raste, opsionet e politikave të studiuara janë diktuar nga politikë-bërësit; kurse në raste të tjera, analisti i përcakton ato. Opsionet e mëposhtme të politikave janë zhvilluar në një proces konsultativ nga ekipi hulumtues. Të gjitha përpjekjet janë bërë për të paraqitur opsionet që reflektojnë dinamikën dhe zgjedhjet që rrisin qëndrime të aksionerëve të rëndësishëm lokal dhe ndërkombëtare mbi këtë çështje.

Hapi i ardhshëm është përpilimi i një kornize strukturore për të zhvilluar fushat e subjektit udhëzues për analizën. Përcaktimi i temës ndihmon në përpilimin e pyetjeve kritike si dhe



përcaktimin e llojeve të informacionit dhe gjykimeve të nevojshme për të vlerësuar. Qëllimi kryesor i tyre është për tu treguar politikë-bërësve dhe lexuesve të tjerë se çfarë duhet të dinë në lidhje me opsionet. Këto fusha fokusohen në çështje të tilla kritike si natyra e opsioneve të politikave, karakteristikat e tyre të performancës, nëse rezultojnë të jenë të suksesshme ose jo, konsideratat më të gjera që ndikojnë në vlerësimin e tyre, dhe meritat e tyre të përgjithshme.

## **5.1 Vështrim i Skenarëve**

**Skenari 1** - Skenari i parë përfaqëson status-quo. Sipas këtij opsioni të politikave, FSK-ja është i mandatuar për të kryer detyrat e mbrojtjes civile dhe të kontribuojë në operacionet humanitare ndërkombëtare. Statusi i saj ligjor është ai i një force të mbrojtjes civile që vepron si një mjet për të plotësuar përgjegjësitë e sigurisë të KFOR-it. Forca do të vazhdojë të jetë e armatosur në nivele bazike, por e kufizuar në mënyrën e operimit të atyre pajisjeve. Gjithashtu, kjo force do të specializohet në vende urbane dhe do të shërbejë në operacione shpëtimi. Madhësia dhe numri i komponentit aktiv dhe rezervë të forcës do të mbetet e njëjtë - 2.500 anëtarë aktivë dhe 800 në komponentin rezervë. Marrëdhëniet e saj të jashtme dhe partneritet ndërkombëtare do të monitorohet rreptësisht nga KFOR-i. Nën këtë skenar, marrëdhëniet kontraktuale dhe anëtarësimi i mundshëm në NATO është i përjashtuar për të ardhmen e parashikueshme.

**Skenari 2** - Sipas skenarit të dytë, Forca ekzistuese e Sigurisë e Kosovës do të transformohet në Forcën Mbrojtëse të Kosovës (FMK). Mandati i Forcës së ardhshme është që të sigurojë integritetin territorial të Kosovës, sigurinë, të sigurojë asistencë për mbrojtje civile, si dhe të kontribuojë për paqen ndërkombëtare. Numri i pjesëtarëve aktivë do të rritet në 3,500 në funksion të detyrave dhe përgjegjësive shtesë. Kjo force do të punojë së bashku me KFOR-in për të siguruar stabilitetin e Kosovës dhe gradualisht do të marrë përgjegjësitë e reja të sigurisë. Buxheti operacional i forcës duhet të rritet në 1.1% të GDP-së (vlerësimet aktuale të rritjes dhe të kursit të këmbimit). FMK-ja do të jetë një partner i barabartë rajonal dhe një kandidat potencial për anëtarësim në NATO.

**Skenari 3** - Sipas skenarit të tretë, FSK-ja do të transformohet në Ushtrinë e Kosovës. Mandati i ushtrisë së ardhshme do të jetë për të siguruar integritetin territorial të Kosovës dhe të kontribuojnë në mbrojtjen civile dhe stabilitetin ndërkombëtar të paqe-ruajtës. Numri i pjesëtarëve aktivë do të rritet në 5,000 në funksion të detyrave dhe përgjegjësive shtesë. Ushtria do të marrë përgjegjësinë primare për të siguruar stabilitetin e Kosovës. Buxheti operacional i forcës duhet të rritet në 1.6% të GDP-së (vlerësimet aktuale të rritjes dhe të kursit të këmbimit). Gjithashtu, Ushtria e Kosovës do të jetë një partner i barabartë rajonal dhe një kandidat potencial për anëtarësim në NATO.


|                                 | <b>Skenari 1</b>                                                    | <b>Skenari 2</b>                                                                                                       | <b>Skenari 3</b>                                                                                                       |
|---------------------------------|---------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emertimi</b>                 | Forca e Sigurise se Kosoves                                         | Forca e Mbrojtjes se Kosoves (Kosovo Defence Force)                                                                    | Ushtria e Kosoves                                                                                                      |
| <b>Mandati</b>                  | Mbrojtje civil dhe kontribut ne operacione humanitare nderkombetare | Mbrojtja e integritetit territorial te Kosoves, mbrojtje civile dhe kontribut ndaj paqes dhe stabilitetit nderkombetar | Mbrojtja e integritetit territorial te Kosoves, mbrojtje civile dhe kontribut ndaj paqes dhe stabilitetit nderkombetar |
| <b>Numri</b>                    | 2,500                                                               | 3,500                                                                                                                  | 5,000 +                                                                                                                |
| <b>Politikat</b>                | Politika te Sigurise                                                | Siguri dhe Mbrojtje                                                                                                    | Siguri dhe Mbrojtje                                                                                                    |
| <b>Marredheniet me KFOR</b>     | Njesi operacionale                                                  | Partner                                                                                                                | Partner                                                                                                                |
| <b>Anetaresimi ne NATO</b>      | JO                                                                  | PO                                                                                                                     | PO                                                                                                                     |
| <b>Pajisjet</b>                 | Armatim i lehte                                                     | Pa kufizime – te percaktuara nga nevojat, kercenimet dhe resurset                                                      | Pa kufizime – te percaktuara nga nevojat, kercenimet dhe resurset                                                      |
| <b>Buxheti (% GDP)</b>          | 0.70%                                                               | 1.10%                                                                                                                  | 1.60%                                                                                                                  |
| <b>SMART</b>                    | Kerkim-shpetim                                                      | Kerkim-shpetim                                                                                                         | Kerkim-shpetim dhe deminim                                                                                             |
| <b>Struktura Institucionale</b> | Ministri e Integruar e FSK-se                                       | Ministri e Integruar e Mbrojtjes                                                                                       | Ministria e ndare nga Shtabi i Pergjitheshem                                                                           |

## ***5.2 Analiza e Skenarëve: Preferencat dhe Implikimet Politike***

Ky seksion do të listoj vizionet dhe ambiciet e akterëve dhe palëve të interesuara. Pas çdo skenari, ushtrimi do të listoj aktorë ndërkombëtar dhe lokal. Ekipi hulumtues ka përdorur deklaratat zyrtare dhe analiza të diskursit në vendosjen e preferencave të akterëve për të tre skenarët e mundshëm. Vlen të theksohet se shumica e akterëve janë përmbajtur nga shprehja e një qëndrimi të qartë duke e vështirësuar saktësinë e motivit të tyre.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, debati mbi të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ishte tema kryesore në vend. Gjysma e dytë e vitit 2013 shënon fundin e kufizimeve të përkohshme ligjore mbi mandatin dhe numrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë kësaj kohe, Qeveria e Kosovës ka lansuar procesin e shqyrtimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë për të përcaktuar rezultatet fillestare pas operacionalizimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Sipas vlerësimeve të Qeverisë, transformimi i Forcës së

Sigurisë së Kosovës është një faktor shumë i rëndësishëm për procesin e shtet-ndërtimit. Përfundimi i misionit të GDN-së në Kosovë dhe fundi i kufizimeve nga Plani i Ahtisaarit tregojnë për një zhvillim natyral dhe gatishmëri për të marrë përgjegjësinë për siguri dhe vet-mbrojtje.



#### Legjende

**Skenari 1 - Preferencat e aktereve**

**Skenari 2 - Preferencat e aktereve**

**Skenari 3 - Preferencat e aktereve**

Nga ana tjetër, NATO e ka njohur përparimin që FSK ka bërë që nga themelimi i saj, por ende nuk ka lëshuar një vlerësim mbi arritjen e FSK-së drejt Kapaciteteve të Plota Operacionale (KPO). Megjithatë, Kosova do të abstenojnë nga një deklaram i njëanshëm për një ushtri nacionale, ku do të vazhdoje ta ruajë statusin dhe mandatin e saj aktual edhe pas qershorit të vitit 2013. Gjithashtu, aftësitë operacionale të FSK-së do të mbetet nën mbikëqyrjen e KFOR-it, dhe në asnjë rrethanë nuk do të tejkalojnë kufizimet e dakorduara me Ligjin e Kosovës mbi FSK-në. Në të kundërtën, NATO duket e gatshme të lëshojë një deklaratë publike, e cila do të vërtetojë se FSK ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale (KPO) të saj dhe do të jetë e gatshme që të marr më shumë përgjegjësi në ofrimin e sigurisë në Kosovë (ELIAMEP, 2013).


Skenari 1 ekzistues e paraqet Forcën e Sigurisë së Kosovës si ndihmë emergjente në rast të fatkeqësive natyrore e rreziqeve të tjera. Përveç kësaj, forca do të jetë në dispozicion për misione të kufizuara rajonale dhe ndërkombëtare të rënë dakord mbi baza bilaterale dhe me lejen e pranisë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë. Kjo forcë për mbrojtje civile do të jetë një qelizë funksionale lokale për të ndihmuar forcat e NATO-s në ofrimin e sigurisë në

Kosovë. Ky skenar ekzistues me siguri do të jetë një opSION i favorizuar nga prania ushtarake ndërkombëtare si arsytim i vështirësive për të dalë me një vizion konsensual për FSK-në. Gjithashtu, status quo-ja do të ndikojë në qëndrimin e disa anëtarëve të NATO-s të cilët kundërshtojnë çdo militarizimin të mëtejshëm të FSK-së. Një rishikim i mundshëm i mandatit të FSK-së do të ndodhë në një fazë të mëvonshme pasi anëtarët që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës mund të kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara. Deri atëherë, Kosova do të dekurajohet nga kërkesa për anëtarësim në NATO.

Megjithatë, skenari ekzistues do të sfidohet vazhdimisht nga krijimi i politikave lokale. Një presion i vazhdueshëm i strukturave të brendshme do të detyrojë pushtetin për veprime të njëanshme dhe plotësime ligjore. Këto ndryshime konsiderohen si një hap i rëndësishëm nga elitat politike të Kosovës sidomos pas përfundimit të mandatit të Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën (ISG). Sidoqoftë, ky proces kërkon presion të konsiderueshëm ndërkombëtar për të ruajtur nivelin e fushëveprimit të akterëve lokal. Gjithashtu, veprimet e njëanshme ndaj ndryshimit të strukturës dhe mandatit institucional të FSK-së do të shkaktojnë tensione në mes të Kosovës dhe disa anëtarëve të NATO-s që mund të ndikojnë në shanset e Kosovës për anëtarësimin në NATO. Veprime të tilla do të shkaktojnë pakënaqësi në Serbi dhe do të komplikojnë më tej marrëdhëniet e Qeverisë me serbët në veri. Gjithashtu, kjo mund të pengojë edhe në përpjekjet për të zbatuar marrëveshjen e Brukselit (2013) dhe të ndikojë që serbët lokal të jenë me rezistent ndaj integritetit në strukturë.

Sipas Skenarit 2, pas certifikimit të NATO-s se FSK-ja ka arritur Kapacitet e Plota Operacionale (KPO), Forca e Sigurisë e Kosovës do të transformohet në Forcën Mbrotjtëse të Kosovës (FMK). Përveç mandatit ekzistues, FMK-ja do të marrë përsipër përgjegjësitë e mëtejshme për të mbrojtur integritetin territorial dhe sigurinë e Kosovës. FMK-ja do vazhdojë të jetë partner i KFOR-it në ushtrimin e përgjegjësive të sigurisë dhe do të mundësojë përgjithësi në rajone të ndryshme gjeografike. Gjithashtu, përveç përgjegjësive të zgjeruara të brendshme, FMK-ja nuk do të ketë kufizime ligjore në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal. Ashtu si në rastin e Ushtrisë së Bosnjës, FMK-ja do të ketë përgjithësi dhe marrëdhënie në të dy nivelet - si një partner në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit, por edhe si një kandidat me anëtarësim të plotë në PfP.

**Global Militarization Index (2010)**



Ky skenar do të jetë në pajtueshmëri me politiken lokale dhe do të lehtësojë presionin e opozitës për veprime të njëanshme. Në mënyrë që të qetësojë shqetësimet e fqinjëve, ligji gjithashtu do të parashikojë një klauzolë që specifikon natyrën e Forcës Mbrotjtëse. Megjithatë, ky skenar do të shkaktojë një kaos të

përkohshëm në mesin e disa anëtarëve të NATO-s. Mirëpo, kjo do të jetë një rezultat i një

ekuilibri natyror dhe do te balancoje kërkesat lokale me shqetësimet ndërkombëtare. Anëtarët e NATO-s që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës mund të zgjidhni për të ruajtur unitetin e Aleancës duke mbajtur marrëdhënie me forcën e paprekur, dhe njëkohësisht duke refuzuar dhënien e ndihmës së drejtpërdrejtë në zbatimin e mandatit të zgjeruar ligjor. Nën strukturën e Skenarit 2, FMK-ja do të hyjë në marrëveshje dypalëshe me anëtarët e NATO-s në mënyrë që të zhvilloj kapacitetet e saja në zbatimin e objektivave të marrjes së përgjegjësive të drejtpërdrejta në sektorin e sigurisë. Ky ushtrim mundëson zgjerimin e fushëveprimit të FMK-se për trajnimin e nevojshëm të kërcënimeve të jashtme mbi Kosovën, por me kufizime të konsiderueshme të burimeve. Ashtu siç paraqitet në Figurën 1 të dhënata nga Indeksi i Militarizimit Global, Kosova është vendi më pak i militarizuar në rajon dhe nuk përbën asnjë kërcënim për stabilitetin rajonal. Qëllimi përfundimtar sipas këtij skenari është që të zhvillojë një forcë të madhe e cila mund të trajtoj rreziqet ekzistuese dhe mund të funksionojë në operacionet ndërkombëtare, por jo shumë e madhe sa të rëndojë buxhetin e Kosovës.


Skenari 3 është opsioni më i preferuar i veprimit për një numër të aktorëve lokal. Përkrahësit më të fuqishëm të këtij opsioni kanë qene Lëvizja Vetëvendosje dhe Veteranët e Luftës. Kjo strukturë e FSK-se është parë si një vërtetësi e shtetësisë së Kosovës, por edhe si një veprim simbolik i nevojshëm për të forcuar sovranitetin e Kosovës. Përkrahësit e këtij opsioni argumentojnë se nuk ka asnjë arsye për të pakësuar ambiciet e Kosovës për sa kohë që siguria e saj është sfiduar nga Serbia. Gjithashtu, pavarësisht ndryshimeve në natyrën e kërcënimeve dhe integritet në NATO, pothuajse të gjitha shtetet kanë kërkuar mënyra të ndryshme avancimi të aftësive të tyre sesa degradimin e statusit apo operacioneve të tyre.

Forca e Sigurisë së Kosovës cilësohet dhe gëzon nivelet më të larta të vlerësimit nga qytetarët e Kosovës. Pothuajse shumica dërrmuese e qytetareve ishin në favor të transformimit të FSK-se në Ushtrinë e Kosovës (Barometri Kosovar i Sigurisë, 2012). Megjithatë, shumë aktorë ndërkombëtarë kanë dyshime në lidhje me përshtatshmërinë e Skenarit 2 dhe veçanërisht Skenari 3. Pavarësisht përmbushjes së kufizimeve të përkohshme ligjore të vëna nën Planin e Ahtisaarit, një numër i aktorëve ndërkombëtarë potencuan se lëvizja drejt transformimit të njëanshme mund të rrezikojë përpjekjet e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Gjithashtu, këto hapa të parakohshëm mund të sfidojnë stabilitetin e brendshëm të Kosovës - popullata lokale serbe dhe sidomos ata që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës mund ta shohin atë si një hap drejt shtrirjes së autoritetit të institucioneve të Kosovës në ato vende përmes përdorimit të forcës.

### **5.3 Implikimet Ekonomike**


Ky seksion është përpjekur të përmbledh burimet e kërkuara në mbështetjen e çdo opsioni të politikave, në mënyrë të qartë duhet të listojë kostot e secilit skenar dhe të masë shpenzimet e planifikuara në krahasim me rritjen momentale ekonomike. Gjithashtu, duhet të listojë mbështetjen ndërkombëtare dhe llojet e veprimeve që kërkohen. Në fakt, nën skenarin ekzistues 1, Kosova ka numrin më të vogël të personelit ushtarak aktiv në krahasim me homologët rajonalë përfshirë Slloveninë si anëtare të NATO-s dhe BE-së. Të dhënat janë bazuar në vlerësimet ndërkombëtare të numrit të personelit ushtarak aktiv për 1000 njerëz në një vend të caktuar (IISS, 2010). Kurse të dhënat për Kosovën janë të krijuara në bazë të Raportit të Regjistrimit të fundit dhe numrit të pjesëtarëve të FSK-së për

**Numri i personelit aktiv ushtarak per 1000 banore (2010)**




këtë periudhe. Edhe pse disa modifikime të vogla mund të ketë ndodhur për shkak të reformave të vazhdueshme në vendet e tjera të rajonit dhe shkurtimeve buxhetore, shifrat vazhdojnë të paraqesin një përfaqësim të përafërt të gjendjes së tanishme. Në këto kushte, një rritje në numrin e personelit ushtarak e propozuar në Skenarin 2 dhe Skenarin 3 do të përmirësonte situatën, duke vazhduar ende të mbesim në nivelin mesatarë rajonal.

**Shpenzimet ne rajon /% GDP**



Shpenzimet ushtarake të Kosovës për vitin 2013 në kuadër të përqindjes së GDP-së është 0.7% (Skenari 1). Ky nivel i shpenzimeve ushtarake është dukshëm më i ulët në krahasim me vendet e tjera në rajon (SIPRI, 2013). Serbia kryeson listën e vendeve të rajonit në aspektin e shpenzimeve ushtarake me 2.3% të GDP-së, pasuar nga Maqedonia (1,7%) dhe Sllovenia (1,6%).


**Shpenzimet e projektuara /%f GDP**



Vetëm Shqipëria ka një përqindje të krahasueshme të shpenzimeve ushtarake me 0.8% të GDP-së. Sipas Skenarit 2, shpenzimet ushtarake të Kosovës do të rriten për 1.1%. Përqindja e shpenzimeve ushtarake nën Skenarin 3 do të rritet për 1.6%, disi më afër me mesataren e shpenzimeve të Sllovenisë në pesë vitet e fundit. Duhet theksuar se shpenzimet ushtarake janë llogaritur mbi bazën e shpenzimeve aktuale për Skenarin 1, ndërsa Skenari 2 dhe Skenari 3 gjithashtu janë

llogaritur në bazë të pritshmërisë së rritjes së personelit dhe investimeve kapitale.

Në afat të mesëm dhe afat të gjatë, Skenari 1 duket të jetë më i përballueshëm dhe i qëndrueshëm. Skenari i dytë përfshin një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve në mbrojtje, si ai i vitit 2015 - duke filluar me gati 63 milion euro dhe gradualisht në rritje për 75 milionë euro në vitin 2020. Rritja graduale e shpenzimeve sipas këtij skenari është i bazuar në supozimin se baza tatimore do të zgjerohet në funksion të rritjes së parashikimeve tepër optimiste të GDP-së gjatë gjashtë viteve të ardhshme. Një rritje në shpenzimet ushtarake domosdoshmërisht do të përfshijë disa shkëmbime - do të ketë më pak burime për investime në sektorë të rëndësishëm të politikave të tjera publike. Zbatimi i Skenarit 2 kërkon mbështetje të jashtme buxhetore - shpesh në dispozicion të vendeve që janë pjesë e programeve të PfP të NATO-s.



Skenari 3 është i kushtueshëm. Në fakt, ky skenar mund të tejkaloj pikën ku humbjet peshojnë më shumë se fitimet e sigurisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në periudha të caktuara kur sfida të tjera të politikave sociale dominojnë agjendën e politikave publike. Edhe pse arsyetimi politik në shpenzimet e shumta ushtarake është zakonisht i bazuar në nevojën për të ruajtur sigurinë nacionale, dinamikat e fundit kanë hapur debatin se nëse rritja e shpenzimeve ushtarake rrit ose përkeqëson ekonominë dhe mirëqenien shoqërore. Këto shkëmbime janë veçanërisht të spikatura për Kosovën e cila ballafaqohet me probleme të rënda ekonomike dhe mungesë të investimeve në fusha të tjera të politikave publike si shëndetësia, arsimi dhe politika sociale. Përkundër sfidave të menjëhershme sociale, vendimet në lidhje veprimet e preferuara duhet të jetë racionale dhe të planifikuara me kujdes.

## 5 REKOMANDIMET DHE KONKLuzionET

- Kosova duhet të krijojë një politike të përgjegjshme të sigurisë e cila është përgjegjëse për ndryshimet në mjedisin strategjik, si dhe në dinamikën e brendshme si një fushëveprim gjithnjë në rritje të kërcënimeve jo-tradicionale.
- Institucionet lokale dhe ndërkombëtare të sigurisë duhet të konsiderojnë me kujdes dinamikën e ndryshimit të kërcënimeve që rezultojnë nga ekspozimi i Kosovës drejt ekonomisë, teknologjisë dhe mjedisit ndërkombëtar.
- Politika e sigurisë së Kosovës duhet të përfshijë një kombinim të mbrojtjes, politikës së jashtme, si dhe aspekteve ekonomike e kulturore.
- NATO dhe aktorët kryesorë ndërkombëtarë duhet gradualisht të udhëheqin procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një Forcë Mbrojtëse të Kosovës e cila është e mandatuar me përgjegjësi për sigurinë, mbrojtjen civile, dhe kontributin në paqe-ruajtjen dhe stabilitetin ndërkombëtar.
- E ardhmja e Forcës Mbrojtëse të Kosovës duhet të trajnohet dhe të jetë e aftë për të kryer detyra dhe përgjegjësi të ndryshme. Forca duhet të jetë e aftë të reagoj në shpejtësi dhe dislokoj, si dhe të trajnojë për të mbështetur sfidat e mjedisit bashkëkohor.
- Kosova duhet të përgatitet në rritjen e shpenzimeve ushtarake për të akomoduar nevojën për 1000 trupa aktiv shtesë duke ofruar trajnim dhe pajisje adekuate.
- Forca e ardhshme e Kosovës duhet të jetë në gjendje dhe e gatshme të hyjë në iniciativat e bashkëpunimit rajonal dhe të rrisë bashkëpunimin dypalësh me anëtarët e NATO-s.
- Ndryshimet ligjore duhet në mënyrë eksplicite të nxjerrin në pah natyrën e kësaj force.
- Dinamikat e implementimit dhe afati kohor duhet të llogaritet në përputhshmëri me shqetësimet e stabilitetit të brendshëm dhe iniciativat e rëndësishme të BE-së për të përmirësuar marrëdhëniet rajonale.
- Elita politike në Kosovë duhet edhe më tej të mbajë dhe të ushqejë partneritetin me NATO-n dhe ti shmangët ndonjë hapi të njëanshëm që mund të rrezikojë anëtarësimin e ardhshëm në NATO.